



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 10, DATË 29.01.2020

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE TË NDODHURA NË STRUKTURËN E
PRONËSISË SË SHOQËRISË “ABC NEWS” SH.A., LICENCUAR PËR
SUBJEKTIN AUDIOVIZIV PRIVAT “ABC NEWS” DHE PËR SUBJEKTIN
AUDIO “ABC NEWS”

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Shoqëria “ABC NEWS” sh.a.

Objekt: Mbi ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “ABC NEWS” sh.a, licencuar për subjektin audioviziv privat “ABC NEWS” dhe për subjektin audio “ABC NEWS”.

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16 i ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe neni 102 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”

VËREN SE:

Shoqëria “Telenorba Shqiptare”, (sot “ABC NEWS” sh.a.), është licencuar nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (sot Autoriteti i Mediave Audiovizive), për subjektin privat vendor “TNSH”, sipas licencës nr. 037/TV. KKRT me vendimin nr. 107, datë 24.09.2010, ka miratuar ndryshimin e emërimit të kanalit televiziv nga “Telenorba

Shqiptare” në “ABC NEWS”. Pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë, me vendimet nr. 853, datë 15.05.2009, dhe nr. 249, datë 03.10.2011, nr. 227, datë 12.10.2016, autoriteti ka rinovuar licencën e subjektit.

Me vendimin nr. 123, datë 08.06.2018, AMA ka pajisur shoqërinë “ABC NEWS” sh.a., me licencë shërbimi programi audioviziv “ABC NEWS”, për të ofruar shërbim në Qarkun Fier. Me vendimin nr.140, datë 04.10.2019, AMA ka pajisur me licencë shërbim programi subjektin edhe për *Qarqet Tiranë- Durrës*. Afati i vlefshmërisë së licencës përfundon në datën 01.01.2026. Zona e ofrimit të shërbimit të subjektit mbështetur në teknologji numerike është *Qarqet Fier, Tiranë dhe Durrës*, ndërsa zona e shërbimit në teknologji analoge është *Qarku Elbasan*.

Po ashtu, subjekti sipas vendimit nr. 120, datë. 28.03.2011, është pajisur me licencë për subjektin audio privat “ABC NEWS” për të ofruar shërbim audio në zonat Rrethet Tiranë, Durrës, Qyteti Fier dhe Qarku Vlorë. Me vendimin nr. 84, datë 16.05.2018, AMA ka rinovuar licencën këtij subjekti.

Me vendimin nr. 148, datë 04.10.2019, ka miratuar ndryshime në strukturën e pronësisë së shoqërisë “ABC NEWS” sh.a.,

Shoqëria “ABC NEWS” sh.a., me shkresën administruar në AMA me nr. 3462 prot., datë 30.09.2019, ka njoftuar për ndryshimin e strukturës së pronësisë së subjektit. Bashkëlidhur njoftimit, subjekti ka depozituar:

- Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit, të lëshuar nga QKB-ja, në datën 25.09.2019, nga shqyrtimi i të cilit rezulton se në datën 24.07.2019, kanë ndodhur ndryshimet e mëposhtme: është larguar ortaku z. Aleksandër Frangaj, i cili zotëronte 50% të aksioneve dhe zj. Alba Gina e cila zotëronte 50% të aksioneve, aksione të cilat i kanë kaluar ortakut të ri dhe të vetëm, shoqërisë “A.B.C. Management” sh.p.k.
- Kontratën noteriale të shitblerjes së kuotave me nr. 1373 rep., dhe nr. 510/2 kol., datë 31.07.2019, lidhur ndërmjet z. Aleksandër Frangaj dhe zj. Alba Gina, në cilësinë e shitësve dhe shoqërisë “A.B.C. Management” sh.p.k., në cilësinë e palës blerëse. Sipas kësaj kontrate, rezulton se aksionarët Aleksandër Frangaj dhe Alba Gina të cilët zotërojnë respektivisht nga 50% të aksioneve në shoqërinë “ABC NEWS” sh.a., kanë kaluar aksionet që zotëronin në këtë shoqëri te ortakut i ri, shoqëria “A.B.C. Management” sh.p.k., 100% të aksioneve;
- Kopje të noterizuar të vërtetimit të gjendjes gjyqësore me nr. 107435, datë 21.08.2019, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Selanik, nga i cili rezulton se zj. Efthymia Gkouma është e padënuar;
- Lëvizje llogarie në bankën OTP, në shumën 800,000 euro;
- CV në gjuhën anglize të znj. Efthymia Gkouma;

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të QKB-së, rezulton se administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “A.B.C. Management” sh.p.k., me NIPT: L91911028V, është Efthymia Gkouma (100% të kuotave).

Më tej, AMA me shkresën nr. 3462/2 prot., datë 24.10.2019, ka kërkuar nga subjekti plotësimin e njoftimit me të dhënat si më poshtë:

1. Dokumente zyrtare mbi vetitë dhe ekspertizën e organeve drejtuese të shoqërisë si dhe të ortakut të ri të subjektit;

2. Vërtetim të zj. Eftimya Gkouma, ortak i vetëm i shoqërisë "A.B.C. Management" sh.p.k., (100% të aksioneve në shoqërinë "ABC NEWS" sh.a., prej institucioneve tatimore dhe/ose sigurimeve shoqërore mbi kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat etj, të derdhura në favor të saj;
3. Të dhëna zyrtare mbi burimet financiare të zj. Eftimya Gkouma, ortak i vetëm i shoqërisë "A.B.C. Management" sh.p.k., (100% të aksioneve në shoqërinë "ABC NEWS" sh.a., si dhe raport të detajuar mbi aspektet e funksionimit ekonomik të shoqërisë "A.B.C Management" sh.p.k., përfshirë këtu parashikimet për të ardhurat dhe shpenzimet për kohëzgjatjen e licencës;
4. Listën emërore të anëtarëve të Bordit Drejtues dhe *Curriculum Vitae* të tyre (të firmosura), nëse ky i fundit do të pësojë ndryshime;
5. *Curriculum Vitae* në gjuhën shqipe të zj. Eftimya Gkouma, të firmosur;
6. Deklaratën noteriale të zotërimit të kuotave/aksioneve që aksionari i vetëm i shoqërisë "ABC NEWS" sh.a., shoqëria "A.B.C. Management" sh.p.k., mund të ketë në subjekte të tjerë audio dhe/ose audiovizivë.

Në vijim të kërkesës së mësipërme, subjekti me shkresën nr. 3462/3 prot., datë 04.11.2019, administruar në AMA, ka depozituar:

- Vërtetim lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, nga i cili konfirmohet pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore për zj. Eftimya Gkouma, për periudhën korrik – shtator 2019;
- Kontratë huaje me nr. 4436 rep., dhe nr. 1917 kol., të datës 19.09.2019, lidhur midis ortakut të vetëm të subjektit (shoqërisë "A.B.C. Management" sh.p.k.) dhe z. Luan Muça, në datën 19 shtator 2019, me afat 30 ditor, për dhënien hua të shumës prej 800,000 euro;
- Pasqyrë të ardhurash dhe shpenzimesh, për vitin 2020;
- Deklaratë noteriale e përfaqësuesit me prokurë të administratorit të shoqërisë "A.B.C. Management" sh.p.k., me nr. 5092 Rep dhe nr. 2123 Kol, datë 31 tetor 2019, sipas së cilës deklarohet se shoqëria nuk zotëron kuota në subjekte të tjerë audio/audiovizivë;
- *Curriculum Vitae* në gjuhën shqipe të zj. Eftimya Gkouma.

Referuar kontratës së sipërcituar për dhënien hua të shumës prej 800,000 euro, lidhur në datën 19 shtator 2019, midis ortakut të vetëm të shoqërisë "ABC NEWS" sh.a. (shoqëria "A.B.C. Management" sh.p.k., aksionar me 100% të kuotave) dhe z. Luan Muça, rezulton se është me afat 30 ditor, afat i cili ka skaduar.

Sa më sipër, AMA, me shkresën nr. 87 prot., datë 13.01.2020, kërkoi informacion mbi shlyerjen e detyrimit sipas kontratës së sipërcituar, ose në të kundërt, ndryshime eventuale që mund t'i jenë bërë këtij dokumenti.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar, konstatohet se burimi i financimit për këtë transaksion tregtar është marrja hua e vlerës monetare.

Në vijim të kërkesës së AMA-s, subjekti me shkresën nr. 111 prot., datë 15.01.2020, ka paraqitur marrëveshje për amendim kontrate huaje me nr. 4436 rep., dhe nr. 1917 kol., datë 19.09.2019, të lidhur në datë 13.01.2020 përpara noterit publik, nga e cila rezulton se palët dakordësojnë se afati për kthimin e huasë 800,000 Euro do të jetë data 12 mars 2020. Kthimi i huasë do të bëhet në llogarinë bankare të huadhënësit, në datën 12 mars 2020, brenda orës 16:00. Në rast se me kalimin e kësaj date, huamarrësi nuk ka përmbytur detyrimin për

kthimin e shumës huadhënësi ka të drejtë që të kërkojë fillimin e procedurave ligjore për ekzekutimin e detyrimit. Subjekti ka depozituar bashkëlidhur edhe prokurën e përgjithshme nga e cila rezulton se zj. Eftymia Gkouma përfaqësohet nga z. Arber Karaj.

AMA vëren se struktura e pronësisë së shoqërisë “ABC NEWS” sh.a., është në përputhje me kërkesat e nenit 62 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në rastin konkret rezulton se, shoqëria “ABC NEWS” sh.a., nuk ka hyrë në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave të jetë veprimtaria radiotelevizive e licencuar, por aksionarët e shoqërisë Aleksandër Frangaj (50% të aksioneve) dhe Alba Gina (50% të aksioneve), kanë kaluar aksionet që zotëronin në këtë shoqëri tek ortakut i ri, shoqëria “A.B.C. Management” sh.p.k., që shndërrohet në aksionarin e vetëm me 100% të aksioneve.

Në mbështetje të parashikimeve të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, subjektet kanë detyrimin ligjor të njoftojnë për ndryshimet e ndodhura në të dhënat e paraqitura në kërkesën për licencë/autorizim, brenda afatit prej 30 ditësh nga data e kryerjes së ndryshimeve. AMA konstaton se ndryshimet e subjektit janë njoftuar brenda afatit të përcaktuar në nenin 133, pika 2/d, të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar.

Sikurse u citua më sipër, konstatohet se është depozituar një akt marrëveshje për amendim kontrate huaje me nr. 4436 rep., dhe nr. 1917 kol., datë 19.09.2019, sipas së cilës afati për kthimin e huasë 800.000 Euro do të jetë data 12 mars 2020. Në rast se me kalimin e kësaj date huamarrësi nuk ka përmbushur detyrimin për kthimin e shumës huadhënësi ka të drejtë që të kërkojë fillimin e procedurave ligjore për ekzekutimin e detyrimit.

Në këto kushte, AMA vlerëson se në vendim duhet të parashikohet detyrimi që shoqëria e licencuar të njoftojë autoritetin mbi respektimin e afateve dhe kushteve të kontratës së huasë, brenda datës 31 mars 2020. Sipas nenit 102 të Kodit të Procedurave Administrative: “1. Një akt administrativ dobiprurës mund të shoqërohet me një ose më shumë prej kushteve të mëposhtme shtesë: ... b) një datë ose një periudhë kohore, në të cilën një e drejtë, një përfitim ose barrë, përkatësisht do të fillojë, përfundojë ose zgjasë; c) një rezervë nga ana e organit publik sa i përket shfuqizimit; dhe/ose ç) një kusht shtesë që kërkon që përfituesi të kryejë, të ndalojë një veprim të caktuar ose të lejojë një veprim të caktuar...”.

Sa më sipër, AMA e gjen të drejtë e të mbështetur kërkesën e shoqërisë “ABC NEWS” sh.a.

PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 102 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “ABC NEWS” sh.a., licencuar për subjektin audioviziv privat “ABC NEWS” dhe për subjektin audio “ABC NEWS”, me aksionar të vetëm, shoqërinë “A.B.C. Management” sh.p.k., 100% të aksioneve.

2. Shoqëria "ABC NEWS" sh.a., licencuar për subjektin audioviziv privat "ABC NEWS" dhe për subjektin audio "ABC NEWS" ka detyrimin të njoftojë AMA-n mbi respektimin e afateve dhe kushteve të kontratës së huasë, cituar në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, brenda datës 31 mars 2020.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA